



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Nr. i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe
Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 18 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Përsheptimin e Përgjigjeve dhe Kundërpërgjigjeve

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullat 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurave dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 18 qershor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi kërkesë për zgjatjen e afatit lidhur me Njoftimin sipas Rregullës 102(3) (“Kërkesa”).²

II. DISPOZITAT LIGJORE

2. Në përputhje me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, trupi gjykues, *proprio motu*, mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje.

3. Në përputhje me rregullën 76 të Rregullores, përgjigjja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh prej dorëzimit të mocionit, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes, në qoftë se ka një të tillë, dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes.

III. DISKUTIM

4. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, afati që ZPS-ja të dorëzojë njoftimin sipas rregullës 102(3) është data 25 qershor 2021.³ Në rast se palët dëshirojnë të dorëzojnë përgjigje ose kundërpërgjigje lidhur me kërkesën e ZPS-së për shtyrjen e afatit, atëherë Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkon që përgjigjet, nëse do të ketë, të dorëzohen deri të mërkurën, 23 qershor 2021, ora 16:00, dhe

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00356, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 18 qershor 2021, publik.

³ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 24 mars 2021, publik, f. 390, rreshti 16 në f. 391, rreshti 9.

kundërpërgjigjet, nëse do të ketë, të dorëzohen deri të enjten në mesditë, 24 qershor 2021.

IV. VENDIM

5. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:
- a. **URDHËRON** që përgjigjet, nëse do të ketë, të dorëzohen jo më vonë se të mërkurën, 23 qershor 2021, ora 16:00; dhe
 - b. **URDHËRON** që kundërpërgjigjet, nëse do të ketë, të dorëzohen jo më vonë se të enjten në mesditë, 24 qershor 2021.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 18 qershor 2021

Në Hagë, Holandë